

Fier, më 17 /04/2021

KALLËZIM PENAL

KALLZUES: PARTIA DEMOKRATIKE DEGA DIVJAKË

ME OBJEKT: Kallëzim i veprës penale , *Neni 248 "Shpërdorimi detyrës"*
, Neni 328 "Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve".

KUNDER:

DREJTUAR: PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË LUSHNJË

I nderuar Z. Prokuror,

Bazuar në nenet 280 dhe 283, si dhe neneve 248, dhe 328 të Kodit Penal, parashtrajmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

I. LIGJI I APLIKUESHEM

1.1. Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 parashikon se:

Neni 280

Marrja dijani për veprën penale

Prokurori dhe policia marrin dijani për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.

Neni 283

Kallëzimi nga ana e shtetasve

Çdo person që ka marrë dijani për një veprë penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.

1.2. Nga ana tjetër Kodi Penal në dispozitat e tij parashikon se: